




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.05.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-861/14, për z. Lulzim Alijaj, për shkak se nuk ka konflikt interesi dhe as papajtueshmëri në mes të funksionit të tij publik si, Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe njëkohësisht anëtar – sekretar i Komisionit për hartimin e Draftit të Kodit Civil.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur, pas pyetjes nga pala e tretë për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK - 03 -02- 861/15, për zyrtarin e lartë, z. Lulzim Alijaj – Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme KPMSHC), është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji PKI).

z. Alijaj është dyshuar për konflikt interesi për shkak se krahas funksionit publik të Kryetarit në KPMSHC, është emëruar anëtar i Komisionit për hartimin e Draftit të Kodit Civil.

Në trajtimin e këtij rasti, fillimisht Agjencia kundër Korrupsionit, në pajtim me ligjin, ka organizuar takim me z. Alijaj dhe e ka njoftuar për faktet që posedon Agjencia në lidhje me situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Bazuar në Ligjin PKI, i cili përcakton kufizimet bazë për zyrtarët e lartë publik për ushtrimin e funksionit publik dhe funksioneve tjera që nuk janë të natyrës publike, zyrtari i lartë z. Lulzim

Alijaj, nuk ka ndonjë kufizim për punën që kryen si anëtar i grupit për Hartimin e Kodit Civil krahas ushtrimit të funksionit publik si kryetar në KPMSHC.

Këtë nuk e ndalon as Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës në të cilin thuhet:

“Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër apo të merr pjesë aktive në aktivitete politike” (neni 7, pika 2). Kjo për arsye se kjo pozitë nuk konsiderohet funksion publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

